




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM



Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Gjiçanit
Nr.06-/2016
Me 04.07.2016 Gjiçan

Lënda: RAPORT PUNE I NJAB-së
Për periudhën 01.01.2016 - 30.06.2016.
(i formës së shkurtër)

Qershor 2016

Raporti i punës së NJAB-së për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016

Në kuadër të këtij gjashtëmujori Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet është bazuar kryesisht në Planin Vjetor të punës për vitin 2016, i cili Planë ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe nga Komiteti për Auditim të Brendshëm.

Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin për Auditim të Brendshëm (LAB), Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit të Brendshëm.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për vitin 2016 janë të planifikuara të kryhen gjithsejtë 14 auditime. Prej tyre një auditim është i planifikuar të bëhet me kërkesë të menaxhmentit të lartë të Komunës.

Për periudhën 6 mujore sipas Planit Vjetor 2016 NJAB-ja ka arritur ti kryej shtatë auditime, dhe një auditim është në proces (në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë).

Në tabelën e mëposhtme do të paraqiten të gjitha auditimet e kryera në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016 sipas Planit Vjetor dhe sipas shkallës së rrezikshmërisë

N.r.	Llojet e detyrave të auditimit të Planifikuara dhe të realizuara në gjashtëmujorin e vitit 2016	Shkalla e rrezikshmërisë sipas Planifikimeve
1	Auditimi në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa: Procesi i shpenzimeve për të gjitha drejtoritë Komunale (me përjashtim të Drejtorisë së Arsimit dhe asaj të Shëndetësisë)	Rrezik i lartë
2	Auditimi në Drejtorinë Komunale të Arsimit - Procesi i Shpenzimeve.	Rrezik i lartë
3	Auditimi në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme: Të hyrat, shpenzimet dhe funksionimi i drejtorisë	Rrezik i mesëm
4	Auditimi në Njësinë e Personelit: Vlerësimi i bazueshmërisë ligjore mbi menaxhimin e resurseve humane dhe sistemin e pagave-mëditjeve	Rrezik i mesëm
5	Auditimi në Shërbimin e Autoparkut: Vlerësimi i zbatueshmërisë ligjore gjatë menaxhimit me automjetet e Komunës	Rrezik i mesëm
6	Auditimi në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa: Të vlerësuarit e bazueshmërisë ligjore lidhur me procedurat e të hyrave vetanake në Administratën Komunale	Rrezik i mesëm
7	Auditimi i procesit të dhënjes dhe arsyetimit të subvencioneve	Rrezik i mesëm

Vlerësimi i objektivave për auditime sipas shkallës së rrezikshmërisë është bërë në Planin Strategjik të NJAB-së për vitet 2016 – 2018, planë ky i aprovuar po ashtu nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm dhe nga Kryetari i Komunës.

Edhe këtë vit duke e pasur parasysh rekomandimin e Auditorit të Përgjithshëm, të gjitha auditimet për fushëveprim e kanë pasur periudhën e pa audituar nga auditimi paraprak e deri në momentin e auditimit (pra të vitit aktual).

Aktivitetet dhe angazhimet e tjera të Njesisë së Auditimit të Brendshëm :

- Në muajin janar, angazhimet tona kryesisht kanë qenë në verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të AB dhe Auditorit të Përgjithshëm të dhëna në auditimet e kaluara, si dhe përgatitja e raportit vjetor të NJAB-së për vitin 2015.
- Në muajin Janar/2015, me kërkesë të Kryetarit të Komunës është përgatitur një Informatë lidhur me procesin e tenderimit për Transportin e nxënësve.
- Në fund të muajit marsë është bërë verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në fund të tremujorit të IV-të të vitit 2015.
- Është raportuar para Komitetit për Auditim të Brendshëm për punën e NJAB-së për tre mujorin e IV-të të vitit 2015, për Raporti Vjetor i NJAB-së për vitin 2015, si dhe për Raportin e NJAB-së për tremujorin e parë 2016.

Këto raporte i janë dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komisionit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.

- Si aktivitete tjera mund të cekim ofrimin e ndihmave profesionale të vazhdueshme për të gjitha Drejtoritë Komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë. Më me veçanti do të cekim ndihmat e ofruara Menaxhmentit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Njesisë së Personelit lidhur me të kuptuarit e rreziqeve, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e tyre, duke e krijuar një regjistër me rreziqe të identifikuar ashtu që menaxhmentet gjegjëse të kenë më lehtë të ushtrojnë kontrollet gjegjëse adekuate për minimizimin e çdo rreziku që mund të jetë pengesë për zbatimin e objektivave të Drejtorive.
Gjithashtu NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e shpenzimeve. Përveç instruksioneve të dhëna kemi dhënë ndihmë sidomos në të kuptuarit e drejtë të procesit të shpenzimeve përmes organigramave të shoqëruara me narrativ.
- Është bërë monitorimi i shumicës së seancave punuese të Kuvendit Komunal. Ky monitorim ka pas qëllim informativ për vendimmarrjet e K.K, si dhe ndryshimet eventuale në legjislacionin e aplikueshëm.

Vlerësimi përmbyllës:

Në këtë gjashtë mujor të parë të vitit 2016 NJAB-ja ka arritur objektivat e planifikuara me Planin Vjetor për vitin 2016, me që ka arritur ti kryej shtatë auditime të cilat kanë pasur një fushveprim mjaftë të gjërë dhe kompleks dhe një auditim është në proces (në Drejtorinë për Gjeodezi, kadastër dhe Pronë).

Në secilin auditim të kryer, pos të gjeturave menaxhmentit të Drejtorisë së audituar i janë dhënë edhe rekomandime për përmirësimin e proceseve dhe sistemeve, duke u bërë në vazhdimësi përcjellja e zbatueshmërisë së atyre rekomandimeve. Pra është arritur të krijohet një bashkpunim produktiv në mesë NJAB-së dhe menaxhmenteve komunale.

Kërkohet një angazhim më konkret i menaxhmenteve të Drejtorive Komunale dhe menaxhmentit të lartë të Komunës për implementimin e rekomandimeve të dhëna si nga Auditori i Përgjithshëm ashtu edhe nga Auditori i Brendshëm.

Drejtori i NJAB-së: _____
/ Sherafedin Latifi /